



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 69, datë 25.06.2024

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.3, DATË 6.02.2024 “PËR MIRATIMIN E HARTËS SË PËRGJITHSHME TË PLAZHEVE TË LEJUARA KU DO TË USHTROHET VEPRIMTARIA SI STACION PLAZHI, PLAZHET PUBLIKE PËR VITIN 2024 SI DHE PLOTËSIMIN E SAJ ME ELEMENTËT E NEVOJSHËM LIDHUR ME STANDARTET E KËRKUARA NGA AKTET LIGJORE NË FUQI”, I NDRYSHUAR**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 43/2020, “Për aktivitetet e turizimit tregtar”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 171, datë 27.3.2019 “Për miratimin e Rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” i ndryshuar, si dhe sipas relacionit të hartuar nga grupi i punës i ngritur me Urdhërin nr.364, datë 04.12.2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK  
V E N D O S I :**



1. Miratimin e një shtese në VKB- nr.3, datë 06.02.2024 “Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara ku do të ushtrohet veprimtaria si stacion plazhi, plazhet publike për vitin 2024 si dhe plotësimin e saj me elementët e nevojshëm lidhur me standartet e kërkuara nga aktet ligjore në fuqi”, i ndryshuar, në lidhje me vendbazimet e mjeteve lundruese.
2. Miratimin e një vendbazimi të ri në plazhin e Gjirit të Lalzit me koordinatat gjeografike: Lindje - 459395.35 m dhe Veri - 4598357.33 m, sipas hartës bashkëngjitur.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 26.06.2024**



P

12



# Vendbazim përballë "Melia"

Data e Printimit: 20.06.2024.

459331.945  
4598438.080

459810.325  
4598438.080



Vendbazim

Koordinatat e vendbazimit:  
East: 459395.35 m  
North: 4598357.33 m




**Legjenda**  
Ortofoto 2015  
20 cm



459331.945  
4598280.888

459810.325  
4598280.888



Digitally signed by  
Elton Zorba  
Date: 2024.06.20  
15:40:51 +0200



Elton Zorba



**Punoi:**  
Elton Zorba

Sistemi koordinativ: KRGJSH  
Projektimi: KRGJSH



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

BASHKIA DURRËS

01.07.24 Nr. 7506/6

Nr. ~~389~~ prot.  
15

Durrës, më 01.07.2024

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.69 datë 25.06.2024 , “Për një shtesë në vendimin e këshillit bashkiak nr.3, datë 6.02.2024 “Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara ku do të ushtrohet veprimtaria si stacion plazhi, plazhet publike për vitin 2024 si dhe plotësimin e saj me elementët e nevojshëm lidhur me standartet e kërkuara nga aktet ligjore në fuqi”, i ndryshuar ”,

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

